



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel:+381 38 244 183 · E-mail: rektorati@uni-pr.edu · www.uni-pr.edu

Fakulteti: Bujqësisë dhe veterinarisë

Departamenti: Lavërtari-Perimtari

Programi: Shkenca Bimore

NJOFTIM

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se :

Ekzemplari (drafti) i temës së masterit i punuar nga kandidati/ja Jehona Birinxhiku, me titull: “Vlerësimi i farës së gjenotipeve të fasules (*Phaseolus vulgaris* L.) për parametra agronomik dhe ndikimi i faktorëve abiotik në cilësinë e mbirjes”

ndodhet në diskutim publik 7 ditë nga data 28.10.2024 deri me datë 05.11.2024.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. Prof. Dr. Imer Rusinovci kryetar
2. Prof. Asoc. Dr. Dukagjin Zeka mentor - anëtar,
3. Prof. Dr. Skënder Kaçiu anëtar

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonte te udhëheqësi shkencor i temës Prof. Asoc. Dr. Dukagjin Zeka , përmes e-mail adresës dukagjin.zeka@uni-pr.edu.

Për të pasur një informacion paraparak më poshtë e gjeni një përmbledhje të shkurtë përmes abstraktit të temës.

Çdo sugjerim i juaji mund të jetë një pasurim i punës tonë !

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË
PROGRAMI STUDIMOR: SHKENCA BIMORE



**VLERËSIMI I FARËS SË GJENOTIPEVE TË FASULES (*Phaseolus vulgaris* L.) PËR
PARAMETRA AGRONOMIK DHE NDIKIMI I FAKTORËVE ABIOTIK NË CILËSINË
E MBIRJES
(Punim diplome)**

MENTORI:
Prof. Asoc. Dr. Dukagjin ZEKA

STUDENTJA:
Bsc. Jehona BIRINXHIKU

Prishtinë 2024

ABSTRAKTI

Fasulja e zakonshme (*Phaseolus vulgaris* L.) është një kulturë e rëndësishme bishtajore dhe kanë vlerë të madhe si për bujqësinë, ashtu edhe për sigurinë ushqimore globale. Këto bishtajore përmbajnë proteina me cilësi të lartë, një sërë mikronutrientësh, vitamina dhe përbërës antioksidantë, duke e bërë fasulen një ushqim të shëndetshëm dhe të domosdoshëm për dietat e balancuara. Gjenotipet e fasules autoktone në Kosovë janë testuar për të kuptuar më mirë diversitetin e tyre agronomik dhe përshtatshmërinë ndaj kushteve lokale. Hulumtimet laboratorike kanë analizuar ndikimin e faktorëve abiotik, si temperatura, mbi mbirjen e farës dhe cilësinë e kulturës. Rezultatet kanë treguar variacione të rëndësishme mes gjenotipeve, duke reflektuar prejardhjen e tyre gjenetike dhe kushtet e zhvillimit. Përmes këtyre analizave, është konstatuar një diversitet i lartë për parametra të tillë si masa absolute, gjatësia dhe gjerësia e farës, përmbajtja e lagështisë dhe sasia e proteinave.

Nga ana statistikore, dallimet e gjetura ishin domethënëse në nivelin $p < 0.01$, çka tregon se ka ndryshime reale dhe të matshme mes gjenotipeve për parametrat e lartpërmendur. Temperatura luan një rol vendimtar në procesin e mbirjes së farës dhe zhvillimit të bimës. Studimi ynë përfshiu tri nivele të temperaturës (8°C, 15°C dhe 22°C), për të matur efektin e saj në mbirjen e farës. Rezultatet treguan se në temperaturën 8°C mbirja dështoi plotësisht, duke treguar se temperatura e ulët është pengesë kritike për këtë fazë. Ndërkohë, në 15°C, përqindja e mbirjes ndryshoi nga 58% deri në 98%, në varësi të gjenotipit të testuar. Në temperaturën 22°C, mbirja arriti nivelin maksimal deri në 100%, duke konfirmuar se kjo është temperatura optimale për mbirjen dhe rritjen e shëndetshme të fasules.

Duke marrë parasysh diversitetin e gjetur në parametrat agronomik dhe burimet gjenetike të fasules, rekomandojmë që të kryhen studime të integruara në fusha eksperimentale, ku të testohen aksesionet më premtuese në kushte reale. Një qasje ndërdisiplinare që kombinon hulumtimin agronomik me analizat gjenetike dhe kushtet mjedisore do të ndihmojë në identifikimin e varieteteve më të përshtatshme për rajone të ndryshme. Këto studime do të kontribuojnë jo vetëm në përmirësimin e prodhimit vendor, por edhe në mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë gjenetike autoktone.

Fjalët kyçe: Fasulja, gjenotipe, parametrat agronomik, faktorët abiotik, temperatura, mbirja e farës.
